



2024

# SAT School Day Bluebook Test Directions with Essay

Translated into Albanian for Students

---

## Notes to the Proctor

### Using this document on test day:

Distribute this document once students are seated.

Students may use this document to read translations of the directions that are read aloud or displayed in Bluebook. Students may keep this document open and on their desk during the entire testing period. Students may **not** be given additional time, unless approved by College Board as a separate accommodation.

Collect this document from each student at the end of testing and securely destroy it.

---

## Shënime për studentin

Në vijim është përkthimi i udhëzimeve që kujdestari juaj do t'i lexojë me zë, si dhe udhëzimeve të shkruara që gjenden në Bluebook. Përcillni udhëzimet derisa kujdestari juaj i lexon ato me zë në anglisht. Nëse keni pyetje rreth asaj se çfarë është duke lexuar kujdestari juaj, ju lutem ngrisni dorën.

- Këto udhëzime të përkthyer mund të mos përshtaten fjalë për fjalë me atë që lexon kujdestari juaj; megjithatë informatat e rëndësishme janë të njëjta.
- Kujdestari juaj mund të kapërcejë disa udhëzime që nuk vlejné për situatën tuaj të testimit.
- Mund ta mbani këtë dokument në tavolinë gjatë gjithë kohës së testimit por duhet t'ia ktheni kujdestarit tuaj pas testimit.
- MOS e përdorni këtë dokument për letër planifikimit të përgjigjes.
- Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, kujdestari i juaj mund të ju jep udhëzime shtesë në gjuhën angleze.
- Ikonat përdoren përgjatë tërë këtij dokumenti për të ju tërhequr vëmendjen në informata specifike:



Informatë e rëndësishme.

I gjithë teksti i hijezuar tregon udhëzimet e thëna nga kujdestari juaj.

# 1 Skripti i ditës së testimit

## 1.1 Mirë se vini

Mirë se vini. Sot jeni duke bërë SAT, një hap të rëndësishëm drejt synimeve tuaja të kolegjit dhe karrierës

Ju lutem dëgjoni me kujdes këto udhëzime: Kur të mbaroj, do t'ju jap kodin e fillimit. Nëse nuk e keni përfunduar ende regjistrimin (check-in), pauzo derisa unë të lexoj. Mund të përfundoni më vonë.

Nëse dëshironi të ndiqni derisa i lexoj këto udhëzime, klikoni **Review the Instructions (Rishikoni udhëzimet)**. Nëse nuk jeni ende në ekranin e kodit të fillimit, klikoni **Help (Ndhimë)** dhe pastaj **Verbal Instructions (Udhëzimet Verbale)**.

Ju pajtoheni të ndiqni rregullat dhe të mbani përmbajtjen e testit konfidenciale. Unë do të përjashtoj këdo që përpiqet të thyejë rregullat dhe rezultatet e tyre do të anulohen. Atyre gjithashtu mund t'u ndalohet t'u nënshtrohen testeve të College Board në të ardhmen.

Bluebook duhet të jetë i vetmi aplikacion i hapur në pajisjen tuaj, nëse nuk përdorni teknologji ndihmëse të miratuar. Aplikacione të tjera të hapura do të zbulohen dhe mund të rezultojnë në anulimin e rezultateve.

Mbyllni të gjitha aplikacionet e tjera tani. Mund t'ju duhet fillimisht të shkëputeni nga Bluebook dhe ta rihapni kur të përfundoni. A ka nevojë dikush të mbyllë aplikacione të tjera?

## 1.2 Pajisjet dhe Materialet

Tani do të vij për t'u siguruar që e keni pastruar bankën tuaj sipas udhëzimeve në Bluebook. Unë do t'ju jap gjithashtu çdo material në lidhje me ndihmesat (akomodimet) tuaja. Dhe nëse keni sjellë një kalkulator, unë do të sigurohem që është i pranueshëm.

Nëse keni telefona, orë të mençur ose pajisje të tjera të ndaluara, fikini ato tani.

Dhe nëse keni sjellë një kalkulator, unë do të sigurohem që është i pranueshëm.

Ju duhet të keni 1 fletë letre për shënime tuaja. Shkruani emrin tuaj të plotë në këndin e sipërm të djathtë. Pas testit duhet ta ktheni atë dhe nuk mund të grisët.

## 1.3 Mbështetësit e Testimit të Akomoduar

Nëse nxënësit testohen me lexues ekrani ose teknologji të tjera asistuese, kujdestari juaj do të lexojë:

Nëse jeni duke përdorur një lexues ekrani ose një teknologji tjetër asistuese të miratuar, tani është koha për t'u siguruar që po funksionon. Mbani në mend, mund të përdorni veçoritë e integruara në pajisjen tuaj.

Më shumë informata janë në dispozicion në faqen e Ndhimës e Bluebook.

Nëse nxënësit testohen me **human reader (lexues njerëzor)**, kujdestari juaj do të lexojë:

Lexuesit duhet t'i lexojnë pyetjet me zë të lartë aq shpesh sa kërkohet. Është e rëndësishme që ata të lexojnë saktësisht atë që është në skript. Ata nuk duhet të shpjegojnë edhe nëse studenti kërkon.

Nëse nxënësit testohen me **scribe (shkrues)**, kujdestari juaj do të lexojë:

Scribes duhet të shkruajnë vetëm përgjigjet dhe korrigjimet që diktojnë studentët. Ata nuk duhet ta drejtojnë studentin në mënyrë që do të rezultonte në një përgjigje të ndryshme. Scribes do t'u lexojnë përgjigjet e studentit prapa nëse studentët duan të rishikojnë punën e tyre.

Nëse nxënësit testohen me **vizatimet e vijës së ngritur**, kujdestari juaj do të lexojë:

Vizatimet e vijës së ngritur kanë të njëjtat etiketa dhe numra si përshkrimet e hollësishme që do t'i dëgjoni.

## 1.4 Pushimet dhe udhëzimet përfundimtare

Ju lutem keni vëmendjen për udhëzimet e pushimeve.

Bluebook do të ju tregoj kur është koha për një pushim. Për të bërë një pushim në çdo kohë tjetër, shkoni te **More (Më shumë)** menya dhe klikoni **Unscheduled Break (Pushim i paplanifikuar)**. Ju do të humbni në kohë për testim nëse bëni një pushim të paplanifikuar.

Nëse keni një asistim (akomodim) të miratuar për pushime sipas nevojës, në vend të asaj zgjidhni **Pause (Pauzo)** te kohëmatësi ashtu që të mos humbni kohën e testimit.

Gjithashtu, qëndroni në heshtje gjatë gjithë kohës, sepse Bluebook llogarit kohën për të gjithë individualisht, dhe ju do të filloni pushimin tuaj dhe do ta përfundoni testin tuaj në kohë pak më të ndryshme nga personat tjerë përreth.

Tani do ti ndaj disa vërejtje të rëndësishme.

Për të shmangur probleme me notimin, lëreni pajisjen tuaj të hapur ose të pambuluar gjatë gjithë testit, duke përfshirë edhe pushimet. Mos e mbyllni Bluebook ose pajisjen tuaj derisa të shihni në ekran **Urime (Congratulations)**.

Nëse koha juaj mbaron dhe nuk e shihni atë në ekran, ngrini dorën. Përndryshe, qëndroni në heshtje me pajisjen tënde hapur derisa të ju liroj.

Ju do të merrni rezultate zyrtare që mund t'i përdorni për të aplikuar në kolegji. Nëse doni të anuloni rezultatet tuaja, më njoftoni në 5 ditët e ardhshme.

Nëse keni nevojë për letër shtesë për shënime ose ndihmë në çdo kohë, ngrini dorën dhe unë do të vij pranë. A ka dikush ndonjë pyetje?


Unë do t'ju jap kodin e fillimit për një çast. Kur të futni kodin dhe klikoni **Filloni Testin (Start test)**, kohëmatësi juaj do të fillojë dhe ju mund të filloni testimin.

Nëse nuk e shihni ende ekranin e kodit të fillimit, përfundoni regjistrimin në Bluebook.

Tani do të lexoj kodin e fillimit dhe do ta shkruaj në tabelë. Sukses!

Kujdestari juaj do të lexoj kodin gjashtë-shifror për fillim dhe do ta shkruaj në tabelë.

## 1.5 Vështrim i përgjithshëm i testit

 Më poshtë është një përkthim i udhëzimeve të Vështrimit të Përgjithshëm të Testit të shfaqura në Bluebook.

SAT me Ese i ka tri pjesë: Leximi dhe Shkrimi, Matematika dhe Ese.

### **Pjesa 1: Leximi dhe Shkrimi (54 pyetje)**

Janë dy module në seksionin Leximi dhe Shkrimi. Çdo modul i ka 27 pyetje.

### **Pjesa 2: Matematikë (44 pyetje)**

Janë dy module në seksionin Matematikë. Çdo modul i ka 22 pyetje.

### **Pjesa 3: Ese**

Është një modul në pjesën e Esesë.


#### **Modulet**

Brenda secilit seksion, të dy modulet maten me kohë ndaras. Nëse koha e lejon, ju mund t'i rishikoni përgjigjet tuaja në një modul të caktuar. Kur kohëmatësi të arrijë zero, ju automatikisht do të vazhdoni tutje. Pasi të shkoni tutje nga cilido modul, nuk mund të ktheheni më tek ai.

#### **Udhëzimet**

Udhëzimet për t'iu përgjigjur pyetjeve shfaqen në fillim të çdo seksioni. Ju mund t'i shikoni këto udhëzime nga këndi i sipërm majtas i ekranit në çdo kohë.

## 1.6 Reading and Writing Module Directions


 Në vijim është një përkthim i udhëzimeve të shfaqura në Bluebook për të dy modulet, Leximin dhe Shkrimin.

### **UDHËZIMET**

Pyetjet në këtë pjesë trajtojnë një sërë aftësish të rëndësishme të të lexuarit dhe të shkruarit. Çdo pyetje përfshin një ose më shumë hyrje, të cilat mund të përfshijnë një tabelë ose grafik. Lexoni me kujdes çdo hyrje dhe pyetje, dhe më pas zgjidhni përgjigjen më të mirë për pyetjen bazuar në hyrjen(t).

Të gjitha pyetjet në këtë seksion janë me zgjedhje të shumëfishta me zgjedhje prej katër përgjigjeve. Çdo pyetje ka një përgjigje të vetme më të mirë.

## 1.7 Math Module Directions

 Në vijim është një përkthim i udhëzimeve dhe fletës referuese të shfaqur në Bluebook për të dy modulet e Matematikës.

### **UDHËZIMET**

Pyetjet në këtë pjesë trajtojnë një sërë aftësish të rëndësishme matematikore.

Përdorimi i një kalkulatori lejohet për të gjitha pyetjet. Te fleta referuese, kalkulatori dhe këto udhëzime mund të qasen gjatë gjithë testit.

Përveç nëse tregohet ndryshe:

- Të gjitha variablat dhe shprehjet paraqesin numra realë.

- Shifrat e dhëna vizatohen në shkallë.
- Të gjitha figurat shtrihen në një nivel/rrafsh.
- Domeni i një funksioni të dhënë  $f$  është grupi i të gjithë numrave realë  $x$  për të cilët  $f(x)$  është numër real.

Për **pyetjet me shumë zgjidhje**, zgjidhni secilën detyrë dhe zgjedhni përgjigjen më të mirë nga zgjidhjet e ofruara. Çdo pyetje me shumë zgjedhje ka një përgjigje të vetme të saktë.


Për **pyetjet me përgjigje të prodhuara nga nxënësit**, zgjidhni çdo detyrë dhe shkruani përgjigjen tuaj siç përshkruhet më poshtë.

- Nëse gjeni **më shumë se një përgjigje të saktë**, shkruani vetëm një përgjigje.
- Mund të shkruani deri në 5 karaktere për një përgjigje **pozitive** dhe deri në 6 karaktere (përfshirë shenjën negative) për një përgjigje **negative**.
- Nëse përgjigjja juaj është një **thyes** që nuk përshtatet në hapësirën e dhënë, shkruani ekuivalentin dhjetor.
- Nëse përgjigjja juaj është një **dhjetore** që nuk përshtatet në hapësirën e dhënë, shkruani duke shkurtuar apo rumbullakosur shifrën e katërt.
- Nëse përgjigjja juaj është një **numër i përzier** (si p.sh.  $3\frac{1}{2}$ ), futeni atë si një thyesë jo të rregullt ( $\frac{7}{2}$ ) ose ekuivalentin e tij dhjetor (3.5).
- Mos shkruani **simbolet** të tilla si një shenjë përqindjeje, presje ose shenjë të dollarit.

#### Shembujt


Përgjigja	Mënyra të pranueshme për të futur përgjigjen	E papranueshme: NUK do të marr kredi/përfitime
3.5	3.5	3 1/2
	3.50	
	7/2	3 1/2
$\frac{2}{3}$	2/3	0.66
	.6666	.66
	.6667	0.67
	0.666	.67
	0.667	
$-\frac{1}{3}$	-1/3	-.33
	-.3333	-0.33
	-0.333	

## Fleta referuese




$$A = \pi r^2$$


$$C = 2\pi r$$




$$A = l w$$





$$A = \frac{1}{2} b h$$




$$c^2 = a^2 + b^2$$




Trekëndëshat e drejtë të veçantë



$$V = l w h$$




$$V = \pi r^2 h$$



$$V = \frac{4}{3} \pi r^3$$



$$V = \frac{1}{3} \pi r^2 h$$



$$V = \frac{1}{3} l w h$$

Numri i shkallëve të harkut në një rreth është 360.

Numri i radianëve të harkut në një rreth është  $2\pi$ .

Shuma e matjeve në shkallë të këndeve të trekëndëshit është 180.

## 1.8 Udhëzimet e Modullit të Esesë



Në vijim është një përkthim i udhëzimeve të shfaqura në Bluebook për modulin e Esesë.

### UDHËZIMET

Eseja ju jep një mundësi për të treguar se sa në mënyrë efektive mund të lexoni dhe kuptoni një pasazh dhe të shkruani një ese duke analizuar pasazhin. Në esenë tuaj, duhet të demonstroi se e keni lexuar pasazhin me kujdes, të paraqitni një analizë të qartë dhe logjike dhe të përdorni gjuhën në mënyrë precize.